



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 163 Prot

Gjirokastrë, më 08.02.2022

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Janinës, Greqi

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Janinës, Greqi, ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Nën këtë grant nga Universiteti i Janinës do të financohen mobilitetet në fushën e **Arsimit Fillor, Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek. (Departamenti i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies, Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek)** si më poshtë:

- **1 pozicion për studentë** (Cikli i I ose II i studimeve) për të ndjekur 1 semester mësimor (6 muaj) në kurset Bachelor ose Master në Departamentin e Arsimit Fillor ose në Departamentin e Greqishtes.
- **1 pozicion për studentë** (Cikli i I ose II i studimeve) për të ndjekur 1 semester mësimor (6 muaj) në kurset Bachelor ose Master në Fushën e Edikimit në Fëmijërinë e Hershme.
- **1 pozicion për studentë** (Cikli i I ose II i studimeve) për të ndjekur 1 semester praktikë (3 muaj) në kurset Bachelor ose Master në Departamentin e Arsimit Fillor ose në Departamentin e Greqishtes.
- **1 pozicion për staf akademik** për trajnim për 5 ditë në Departamentin e Arsimit Fillor.

Planifikimi i aktivitetit mësimor/ mësimdhënës/ mësimnxënës do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2021-2022**, semestri i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B1 ose Greqisht B1 për studentët dhe Anglisht B2 për stafin për trajnim.

Ftohen gjithë të interesuarit, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **14.02.2022**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni do të shqyrtohet nga autoriteti përkatës dhe më pas vlerësimi përfundimtar do t'u bëhet me dije aplikantëve.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

